

**Mesazh urimi për shërimin e Kryepiskopit Anastas dërgon edhe Patriarku i Bullgarisë z. Daniel, duke i uruar shërim të shpejtë Fortlumenturisë së Tij Kryepiskopit të Shqipërisë, z. Anastas.**



Mesazh urimi për shërimin e Kryepiskopit Anastas dërgon edhe Patriarku i Bullgarisë z. Daniel, duke i uruar shërim të shpejtë Fortlumenturisë së Tij Kryepiskopit të Shqipërisë, z. Anastas.

Në mesazhin e tij, Patriarku i Bullgarisë drejtohet:

“Në këtë ditë, në të cilën kremtojmë kujtimin e Profetit të shenjtë, Pararendësit dhe Pagëzorit të Zotit, Joanit , predikuesit të mrekullueshëm të pendimit, ju drejtohem juve, Fortlumenturi, që keni qenë gjithmonë me vepra dhe me fjalë një predikues pendimi dhe shpëtimi, ungjillëzues i palodhur i fjalës së Zotit dhe ndërgjegjie e gjallë kanonike e Kishës. Me lutje ju urojmë shërim të shpejtë me ndihmën e hirit të Perëndisë, i cili “përsoset në dobësi” (2 Kor. 12:9). Zoti i Tërëmirë nëpërmjet

lutjeve të Nënës së Tij të Tërëshenjtë, ju dhëntë shëndet të mirë dhe forcë për të kapërcyer sprovën e tanishme dhe për të vazhduar t'i shërbeni Kishës së Shenjtë në të ardhmen - si shembull për të gjithë ne, ashtu siç gjithmonë keni qenë në të shkuarën.”

burimi: <https://www.orthodoxianewsagency.gr/.../eyxes-gia.../...>

[Radio “Ngjallja”](#)